



Pranuar / Dorezuar Prilomen/Prilodato Received/Delivery	27 - 10 2020	viti god year	0
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHX	2294/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A . Nr. 260/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi - Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani, dhe Jeton Koca anëtar, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A. Nr.260/2020, të datës 04.09.2020, së ankuesit [REDACTED] me adrese banimi rruga „Ramë Obranqa, NR. 22, nga Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Sekretariatit të Komisioni Qendror Zgjedhor, në çështjen juridike “ kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.10.2020, mori këtë;

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A. Nr. 260/2020 e datës 04.09.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datën 11.06.2020, ka nxjerr vendim me numër protokolli 557/2020, me të cilin ka shfuqizuar vendimin me numër protokolli 798/2018 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe te Ankesave, te datës 07.12.2018. Po ashtu Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datën 11.06.2020, nxjerr vendim me numër protokolli 560/2020, me të cilin ka emëruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Ankuesi [REDACTED] Zyrtar i lartë ne Komisionin Zgjedhor ne Podujeve, i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 557/2020, të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, te dates 11.06.2020, me datën 10.07.2020, parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave te Sekretariatit te Komisionit Qendror Zgjedhor.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe te Ankesave te Sekretariatit te Komisionit Qendror Zgjedhor, me datën 05.08.2020 merr vendim me numër protokollit 710/2020, me të cilin e refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit Islam Demolli.

Ankuesi [REDAKTUAR] me i pakënaqur me vendimin e datës 05.08.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe vendimin me numër protokollit 557/2020 të datës 11.06.2020, të Kryeshefi Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me datë 04.09.2020 parashtron ankesë me numër protokollit 1697/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Sekretariti i Komisionit Qendror Zgjedhor, për përgjigje në ankesë me datë 14.09.2020, ndërsa me datën 24.09.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Sekretariti i Komisionit Qendror Zgjedhor, me provat e bashkangjitura.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr.260/2020, me numër protokollit 1697/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 05.08.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datës 10.07.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 11.06.2020; Vendimi i datës 11.06.2020; Vendimi i datës 07.12.2018; Përgjigje në ankesë e datës 24.09.2020, me numër protokollit 1890/2020, me shkresat e bashkangjitura; Vendimi numër protokollit 1/2020 I datës 14.10.2020 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A. Nr. 260/2020 të datës 04.09.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR]

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit [REDAKTUAR] është bërë i pamundur *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmimeve zyrtare gjegjësisht Vendimit me numër me protokollit 557/2020 të datës 11.06.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me të cilin ka shfuqizuar vendimin me numër protokollit 798/2018 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe te Ankesave, të datës 07.12.2018 , si dhe Vendimin me numër protokollit 560/2020, të datës 11.06.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me të cilin ka emëruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ka konstatuar që ankuesit [REDAKTUAR], nuk iu është shkëlur asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës me rastin e nxjerrjes së këtyre dy vendimeve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke marr parasysh pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me „ndërprerjen e mandatit,, si anëtar i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe te Ankesave, dhe pasi që në bazë të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht Vendimit me numër me protokollit 557/2020 të datës 11.06.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me të cilin ka shfuqizuar vendimin me numër protokollit 798/2018 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, të datës



07.12.2018 , si dhe Vendimit me numër protokoll 560/2020, te datës 11.06.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, me të cilin ka emëruar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ka konstatuar se emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave është e drejte ekskluzive e Sekretarit të Përgjithshëm, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se me këtë vendim ankuesit [REDACTED] nuk i është ndryshuar akt emërimi, respektivisht ndaj të njëjtit nuk ka ulje në pozitë dhe asnjë ndalesë të pagës, andaj duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar që „Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë” ka konstatuar që janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 260/2020

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetare e Kolegjit

Rushit Kajtazi
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretarit të Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Arkivit të KPMSHCK-së

